

## THIRRJE

**PËR PJESËMARRJE NË PROVIMET QË ZHVILLOHEN NË “NEW GENERATION”**

**PËR MARRJEN E TITULLIT**

**“NDIHMËSMJESHTËR”, “MJESHTËR” DHE “MJESHTËR ME PËRVOJË”,**

*për të gjithë profesionistët - ish studentë të “New Generation”, që punojnë në sektorin e Parukerisë, Estetikës, Masazherisë Estetiko kuruese, Fizioterapië - Estetike, Make-up, Manikyr – Pedikyr, Berber*

New Generation në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Zejtarisë (DHKZ) mbështetur edhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit që kanë nënshkruar palët, më datë 13.04.2021, ka hapur fazën paraprake për provimet për marrjen e titujve “Ndihmësmjeshtër”, “Mjeshtër” dhe “Mjeshtër Përvojë”

Marrja e titullit dhe certifikatës përkatëse ndihmon ish studentët tanë të New Generation të ecin në karrierën e tyre profesionale në përputhje me ligjin Nr. 70/2016 “Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”

Së dyti, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DHKZ dhe Dhomës Kombëtare të Zejeve në Koblenz, Gjermani, nënshkruar më këto tituj/certifikata njihen edhe në Gjermani.

Bazuar në dokumentat e sipërcituar, secili ish-student, apo ish kursant që e gjykon që në profesion duhet të zhvillosh karrierën në mënyrë që të përshtatesh me kërkesat e kohës, është i ftuar të marrë pjesë në provimet e kualifikimit që do të organizohen në Maj 2021.

### **Provimet**

- a. Provimet për marrjen e titujve “Mjeshtër me përvojë”, “Mjeshtër” dhe Ndihmësmjeshtër” zhvillohen në ambientet e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, dhe në ambientet e QMNG, nën kujdesin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.
- b. **Provimi i teorisë** është provimi i detyruar që vërteton se pjesëmarrësit zotërojnë njohuritë teorike profesionale më themelore për marrjen e titullit përkatës.
- c. **Provimi i praktikës** /prezantimi i përvojave më të mira, janë të detyruara që vërteton se individit ka fituar aftësitë praktike profesionale më themelore për marrjen e titullit.
- d. *Provimi i teorisë dhe i praktikës profesionale mbikqyret* nga Komisioni i ngritur nga DHKZ. në bazë të rregullores “Për zhvillimin e provimeve, si dhe përbërja e komisioneve për dhënien e titujve ‘Mjeshtër me përvojë’, ‘Mjeshtër’ dhe ‘Ndihmësmjeshtër’ në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë”, miratuar nga DHKZ.

- e. Kalimi me sukses i provimit i jep individit titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Mjeshtër”. ose “Ndihmësmjeshtër”

#### **Kohëzgjatja e provimit:**

- a. Provimi me shkrim i teorisë zgjat 2 (dy) orë (120 minuta).
- b. Provimi i praktikës për secilin aplikant zgjat jo më pak 2 (dy) orë dhe jo më shumë se 9 (nëntë) orë, të ndara në dy ditë, në varësi të drejtimit dhe të profilit përkatës.

#### **Komisioni i vleresimit të aftësive të fituara që jep titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Mjeshtër” dhe “Ndihmësmjeshtër”**

Në bazë të Rregullores së veprimtarisë së DHKZ, komisioni përbëhet nga:

1. Presidenti / Sekretari i Përgjithshëm ose një titullar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
2. Një anëtar i Kryesisë /Asamblesë ose një specialist në sektorin përkatës
3. Specialist i fushës/ përfaqësues i QMNG me të cilin bashëpunon DHKZ, sipas Nenit 3 të kësaj rregulloreje

#### **Vlerësimet e provimeve**

1. Për provimin e teorisë profesionale të integruar:
  - a. Vlerësimi bëhet në bazë të skemës së vlerësimit të hartuar nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me QMNG
  - b. Secili prej anëtarëve bën vlerësim individual.
  - c. Vendosja e notës përfundimtare bëhet pas diskutimit mes anëtarëve komisionit.
2. Për provimin e praktikës profesionale të integruar:
  - a. Vlerësimi bëhet në bazë të skemës së vlerësimit të hartuar nga komisioni.
  - b. Secili prej anëtarëve të komisionit bën vlerësim individual.
  - c. Vendosja e notës përfundimtare bëhet pas diskutimit mes anëtarëve të komisionit.

#### **ORGANIZIMI, ADMINISTRIMI DHE VLERESIMI I PROVIMEVE PERFUNDIMTARE**

##### **1. Në periudhën paraprake, DHKZ dhe QMNG realizojnë:**

- a) Hartimin e listës së personave që do të kalojnë në proces kualifikimi për marrjen e titujve “Ndihmësmjeshtër”, “Mjeshtër” dhe “Mjeshtër me përvojë”.
- b) Mbledhjen e dosjeve të aplikantëve dhe vlerësimin e tyre
- c) Bashkëpunimin me DHKZ për të ndihmuar në organizimin paraprak të provimeve, publikimin e datave të provimeve që do të vendosen së bashku me DHKZ, si dhe

mbarëvajtjen e provimeve për titullin “Ndihmësmjeshtër”, “Mjeshtër” dhe “Mjeshtër me përvojë

## **2. Administrimi i procesit të provimit kryhet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë.**

- a) DHKZ bashkëpunon me QMNG sipas Nenit no. 3 të Rregullores për provimet “Mjeshtër me Përvojë”, “Ndihmësmjeshtër” dhe “Mjeshtër”, të DHKZ.
- b) DHKZ dhe QMNG organizojnë dhe ndjekin punën për përgatitjen e përmbajtjes së provimit të teorisë dhe provimit të praktikës si dhe për hartimin e skemave përkatëse të vlerësimit.
- c) DHKZ dhe QMNG organizojnë dhe ndjekin punën për sigurimin e bazës materiale dhe për shumëfishimin e materialeve të shkruara, si për provimin e teorisë, ashtu dhe atë të praktikës. Organizon dhe ndjek punën për përgatitjen e mjediseve për zhvillimin e provimeve (si të teorisë ashtu dhe të praktikës).
- d) DHKZ dhe QMNG mbikëqyrin respektimin e orarit të zhvillimit të provimeve.
- e) DHKZ dhe QMNG dokumentojnë çdo parregullsi si dhe masat që janë marrë gjatë zhvillimit të provimit.
- f) DHKZ dhe QMNG kryejnë veprimet përmbyllëse të administrimit të procesverbaleve.
- g) DHKZ dhe QMNG shpallin rezultatet e provimeve jo më vonë se 1 (një) ditë pas përfundimit të çdo provimi.

## **3. Lëshimi i certifikatave të titujve**

1. Certifikatat përkatëse për titujt e fituar lëshohen nga DHKZ brënda afateve.
2. Modeli i Certifikatës përcaktohet nga DHKZ;
3. Certifikata i lëshohet vetëm personit, dhe vetëm pasi ai të ketë shlyer detyrimet financiare, të përcaktuar në rregulloren e DHKZ.
4. QMNG, në bazë të politikave të saj të lehtësimit dhe të përkrahjes për studentët e saj, mund të bëjë edhe subvencionin e saj të pjesshëm ose të plotë.

## **AFATET KOHORE TË EKSPERIENCËS NË PROFESION QË NEVOJITEN PËR TË HYRË NË PROVIMET PËR MARRJEN E TITUJVE**

Periudhat/ afatet kohore të eksperiencës në profesion që nevojiten për t’u plotësuar nga një provim në provimin tjetër të nivelit më të lartë synojnë:

- a) vendosjen e profesionistëve në kushte të barabarta, pavarësisht në ç’rrugë e kanë filluar profesionin, për ecurinë e suksesshme në karrierë
- b) vleftësimin e njohjes së të nxënit të mëparshëm që studentët e New Generation kanë marrë.



- c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.
- d) ruajtjen e cilësisë së profesionit dhe shërbimeve që i ofrohen klientelës.

### Skema e marrjes së titujve, në mënyrë të njëpasnjëshme

1. Më poshtë, bazuar edhe në VKM nr. 3, 2020 “Për kohën e nevojshme që i duhet Ndhmësit për kualifikimin me njohuritë praktike pranë një mjeshtri dhe me njohuritë teorike në një insitucion arsimor”, paraqiten të gjitha shkallët e ecurisë së punonjësve në profesionet e Përkujdesit dhe Artit Trupor, për marrjen e titujve në mënyrë të njëpasnjëshme, me shpjegimet përkatëse, të miratuara.
2. Skema është ndërtuar duke marrë parasysh të gjitha rastet (e mundshme) të fillimit të një karriere në një profesion.

Rastet e mundshme janë:

**Rasti parë:** Një person që ka mbaruar shkollë 9 - vjeçare, dhe **ka kryer një kurs 3-mujor** në zejen përkatëse, të ofruar nga NG:

- Duhet të jetë regjistruar në subjektin zejtar (ose në disa të tillë njëri pas tjetrit) dhe duhet të ketë punuar si **Ndhmës** të paktën **3 vite**. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin “**Ndhmësmjeshtër**”. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike nga kujdestari/ët e vet profesionalë, jo më pak se 350 orë në vit (10 orë në javë/për 35 jave) në dy vitet e para.
- Për të marrë titullin “**Mjeshtër**”, atij i duhet të ketë punuar si “**Ndhmësmjeshtër**” të paktën edhe 3 vite (pranë një mjeshtri).<sup>o</sup>
- Për të marrë titullin “**Mjeshtër me Përvojë**” atij i duhet të ketë punuar të paktën edhe 10 vite si “Mjeshtër”.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 1 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje.

**Rasti dytë:** Një person që ka mbaruar shkollë 9 - vjeçare, dhe **ka kryer një kurs 6-mujor** në zejen përkatëse, të ofruar nga NG:

- Duhet të jetë regjistruar në subjektin zejtar (ose në disa të tillë njëri pas tjetrit) dhe duhet të ketë punuar si **Ndhmës** të paktën **2.5 vite**. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin “**Ndhmësmjeshtër**”. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike nga kujdestari/ët e vet profesionalë, jo më pak se 350 orë në vit (10 orë në javë/për 35 jave) në dy vitet e para.
- Për të marrë titullin “**Mjeshtër**”, atij i duhet të ketë punuar si “**Ndhmësmjeshtër**” të paktën edhe 3 vite (pranë një mjeshtri).
- Për të marrë titullin “**Mjeshtër me Përvojë**” atij i duhet të ketë punuar të paktën edhe 10 vite si “Mjeshtër”.



Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 2 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje.

**Rasti tretë:** Një person që ka mbaruar shkollë 9 - vjeçare, dhe **ka kryer një kurs 9-mujor** në zejen përkatëse, të ofruar nga NG:

- Duhet të jetë regjistruar në subjektin zejtari (ose në disa të tillë njëri pas tjetrit) dhe duhet të ketë punuar si **Ndihmës** të paktën **2 vite**. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin **“Ndihmësmjeshtër”**. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike nga kujdestari/ët e vet profesionalë, jo më pak se 350 orë në vit (10 orë në javë/për 35 javë) në dy vitet e para.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër”**, atij i duhet të ketë punuar si **“Ndihmësmjeshtër”** të paktën **3 vite** (pranë një mjeshtri).
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** atij i duhet të ketë punuar të paktën **10 vite** si **“Mjeshtër”**.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 3 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje.

**Rasti katërt:** Një person që ka kryer një shkollë të mesme të përgjithshme/ ose profesionale jo në në profesionin përkatës, **dhe ka kryer një kurs 3-mujor** në zejen përkatëse, të ofruar nga NG:

- Duhet të ketë punuar si **“Ndihmës”** të paktën **2 vite**. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike në NG, në dy vitet e para: 700 orë **minus** orët e teorisë të kryera në kursin e kualifikimit 3-mujor. Vendimi për zbritjen e orëve merret nga **institucioni arsimor**, ku do të merren njohuritë teorike. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin **“Ndihmësmjeshtër”**.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër”**, atij i duhet të ketë punuar **“Ndihmësmjeshtër”** edhe të paktën **3 vite** (pranë një mjeshtri) dhe fiton kështu të drejtën për të hyrë në provim.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** atij i duhet të ketë punuar të paktën **edhe 10 vite** si **“Mjeshtër”** dhe fiton të drejtën për të hyrë në provim.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 4 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje.

**Rasti i pestë:** Një person që ka kryer një shkollë të mesme të përgjithshme/ ose profesionale jo në në profesionin përkatës, **dhe ka kryer një kurs 6-mujor** në zejen përkatëse, në NG:

- Duhet të ketë punuar si **“Ndihmës”** të paktën **1.5 vite**. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike në NG, me kohë të pjesshme: 700 orë **minus** orët e teorisë të kryera në kursin e kualifikimit 6-mujor. Vendimi për zbritjen e orëve merret nga **institucioni arsimor**, ku do të merren njohuritë teorike. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin **“Ndihmësmjeshtër”**.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër”**, atij i duhet të ketë punuar **“Ndihmësmjeshtër”** edhe të paktën **3 vite** (pranë një mjeshtri) dhe ka fituar kështu të drejtën për të hyrë në provim.



- Për të marrë titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** atij i duhet të ketë punuar të paktën edhe 10 vite si **“Mjeshtër”** dhe ka fituar të drejtën për të hyrë në provim.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 5 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje.

**Rasti i gjashtë:** Një person që ka kryer një shkollë të mesme të përgjithshme/ ose profesionale jo në një profesionin përkatës, dhe ka kryer një kurs 9 mujor/shkollë 1-vjeçare profesionale pas të mesmes, në NG:

- Duhet të ketë punuar si **“Ndhmës”** të paktën **1 vit**. Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike në NG, me kohë të pjesshme: 700 orë **minus** orët e teorisë të kryera në kursin e kualifikimit 9-mujor. Vendimi për zbritjen e orëve merret nga **institucioni arsimor**, ku do të merren njohuritë teorike. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin **“Ndhmësmjeshtër”**.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër”**, atij i duhet të ketë punuar **“Ndhmësmjeshtër”** të paktën edhe 3 vite (pranë një mjeshtri) dhe ka fituar kështu të drejtën për të hyrë në provim.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** atij i duhet të ketë punuar të paktën edhe 10 vite si **“Mjeshtër”** dhe ka fituar të drejtën për të hyrë në provim.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 6 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje;

**Rasti i shtatë:** Një person që ka kryer një shkollë të mesme të përgjithshme/ ose profesionale jo në një profesionin përkatës, dhe ka kryer një shkollë 2-vjeçare profesionale pas të mesmes në fushën përkatëse, në NG:

- Duhet të ketë punuar si **“Ndhmës”** të paktën **6 muaj**. Pas kësaj i lind e drejta të hyjë në provim për të marrë titullin **“Ndhmësmjeshtër”**.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër”**, atij i duhet të ketë punuar **“Ndhmësmjeshtër”** të paktën edhe 2 vite (pranë një mjeshtri) dhe fiton kështu të drejtën për të hyrë në provim.
- Për të marrë titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** atij i duhet të ketë punuar të paktën edhe 10 vite si **“Mjeshtër”** dhe fiton të drejtën për të hyrë në provim.

Kjo situatë është shpjeguar në rrjeshtin 7 të tabelës në shtojcë në fund të kësaj rregulloreje;

## KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË INDIVIDU QË TË FITOJË TITULLIN “MJESHTËR ME PËRVOJE”, “MJESHTËR” DHE “NDIHMËS MJESHTËR” NGA DHOMA KOMBËTARE E ZEJTARISË

A) Për të fituar titullin **“Mjeshtër me Përvojë”** aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:

### Kritere të detyrueshme

- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë



- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë mbi 10 vite eksperiencë pune në profesion, në rastin e parë dhe mbi 15 vite eksperiencë në profesion në rastin e dytë (shih shtojcen 1)
- f. Të jetë vlerësuar të paktën një herë për një punë të vecantë të tij ( punë inovative)
- g. Të ketë eksperiencë në trajnimin dhe kualifikimin e ndihmësve, ose ndihmës mjeshtërve
- h. Të ketë promovuar aktivitetin e tij dhe aftësinë krijuese
- i. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë

#### **Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të paraqesë Leter referencë nga punëdhënës të mëparshëm
- b. Të ketë kualifikime të tjera të certifikuara në profesionin e caktuar
- c. Të ketë njohuri në implementimin e mekanizmave të reja në fushën e tij
- d. Të ketë botuar një libër në profesion
- e. Të ketë mbikqyrur të paktën 5 ndihmës qe u ka mësuar zejen
- f. Të ketë pasur angazhime dhe të ketë shkëmbyer përvoja kombëtare dhe ndërkombëtare
- g. *Gjate provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demostrojë një punë inovative të tij e cila e identifikon dhe për të cilën është vlerësuar.*

#### **B) Për të fituar titullin “Mjeshtër” aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:**

##### **Kritere të detyrueshme**

- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune si “Ndhmësmjeshtër” (shih shtojcen 1)
- f. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë
- g. Të përvetësojë informacionin e duhur për provim i dhënë nga Komisioni sipas fushës përkatëse dhe i shpallur në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

##### **Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të ketë njohuri në implementimin e mekanizmave të reja në fushën e tij





- b. Të ketë të paktën 1 certifikatë kombëtare /ndërkombëtare
- c. *Gjatë provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demonstrojë një punë inovative të tij e cila e identifikon dhe për të cilën është vlerësuar.*

**C) Për të fituar titullin “Ndhmës Mjeshtër” aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:**

**Kritere të detyrueshme**

- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë përfunduar kohën e përcaktuar sipas kontratës për kualifikimin profesional ndërmjet ndihmësit dhe subjektit zejtar të regjistruar në regjistrin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë<sup>1</sup> (shih shtojcën 1)
- f. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë
- g. Të përvetësojë informacionin e duhur për provim i dhënë nga Komisioni sipas fushës përkatëse dhe i shpallur në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

**Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të zotërojë njohuri teorike dhe praktike të nevojshme në ushtrimin jo të pavarur në profesionin përkatës
- b. Të ketë të paktën 1 certifikatë kombëtare /ndërkombëtare
- c. *Gjatë provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demonstrojë se zotëron njohuritë e nevojshme në ushtrimin jo të pavarur të profesionit përkatës*

**TARIFA E PROVIMIT PËR TITULLIN “MJESHËR ME PËRVOJË”, “MJESHTËR” DHE NDIHMËSMJESHËR**

1. Sipas Nenit 20 Të Ligjit për ‘Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë’ Shpenzimet për dhënie e provimit për titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Ndhmësmjeshtër” dhe “Mjeshtër” i mbulon personi që i nënshtrohet provimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.
2. Ministri përgjegjës për Kualifikimin Profesional, me propozimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, përcakton me udhëzim tarifat e dhënies së provimit për titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Ndhmësmjeshtër” dhe “Mjeshtër”. Në përcaktimin e tarifave Ministri përg

<sup>1</sup> Sipas pikës B të Kontratës për kualifikimin profesional ndërmjet ndihmësit dhe subjektit zejtar, kontrata është e publikuar në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë [www.dhkz.org.al](http://www.dhkz.org.al) dhe në fletoren zyrtare




jegjës për Kualifikimin Profesional mban parasysh politikat përfshirëse për grupet e veçanta, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

## ANKIMIMI

Sipas nenit 21 pika 1 të ligjit nr 70/2016'' Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë'':

1. Personi mund të ankimojë rezultatin e provimit.
2. Vendimet e komisioneve të vlerësimit mund të ankimohen në komisionin e apelit, i cili ngrihet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me Ministrinë Përgjegjëse për Kualifikimet / institucionet përkatëse të përmendura në Nenin 3 të kësaj rregullorje.
3. Nëse aplikanti për titull nuk e kalon provimin atëherë ai ka të drejtë të aplikojë përsëri dhe pagesa e provimit të parë nuk është e vlefshme për provimet e tjera.



## SHTOJCA 1

**Tabelë:** Skema e marrjes së titujve, në mënyrë të njëpasnjëshme, bazuar edhe në VKM nr. 3, 2020 “Për kohën e nevojshme që i duhet Ndhmësit për kualifikimin me njohuritë praktike pranë një mjeshtri dhe me njohuritë teorike në një institucion arsimor”

	Shkollë 9-vjeçare	Shkollë të mesme e përgjithshme/Shkollë profesionale jo në fushën përkatëse	Certifikatë			Diplomë Profesionale, jouniversitare 2-vjeçare	Koha e nevojshme për Ndhmësin		Përvojë pune si Ndhmës Mjeshër	Përvojë pune si Mjeshër
			3-Mujore	6-Mujore	9-Mujore (1 vjeçare)		Përvojë pune në profesion*)	Njohuri teorike (orë mësimore)		
Rasti 1	PO	-	PO	-	-	-	3 vite	700 orë minus orët teorikë të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 2	PO	-	-	PO	-	-	2,5 vite	700 orë minus orët teorike të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 3	PO	-	-	-	PO	-	2 vite	700 orë minus orët teorike të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 4	PO	PO	PO	-	-	-	2 vite	700 orë minus orët teorike të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 5	PO	PO	-	PO	-	-	1.5 vite	700 orë minus orët teorike të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 6	PO	PO	-	-	PO	-	1 vit	700 orë minus orët teorike të kursit **)	3 vite	10 vite
Rasti 7	PO	PO	-	-	-	PO	6 muaj	-	2 vite	10 vite
<p>*) Gjatë kësaj kohe duhet të ketë marrë njohuri teorike në një institucion arsimor, ofruar i AFP-së, jo më pak se 350 orë në vit (10 orë në javë/për 35 javë) në dy vitet e para.</p> <p>**) NJNM (zbritja e orëve teorike) bëhet nga institucioni arsimor ku do të merren njohuritë teorike.</p>										

Fiton të drejtën për të hyrë në provim për marrjen e titullit:

Mjeshër

Mjeshër me përvojë